

**Njoftim i përqendrimit me të cilin Shoqëria për tregti dhe shërbime të jashtme dhe të brendshme  
NELT KO. d.o.o. Dobanovci nga Republika e Serbisë do të fitoj kontrollin e vetëm mbi SelfNest  
d.o.o. Beograd-Zvezdara nga Republika e Serbisë**

**(Lënda nr. 08-147 viti 2022)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 31.10.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftimi i përqendrimit, i cili i referohet marrjes së kontrollit të vetëm nga Shoqëria për tregti dhe shërbime të jashtme dhe të brendshme NELT KO. d.o.o. Dobanovci, Republika e Serbisë me seli në rrugën Marshall Tito nr. 2266, Dobanovci, Republika e Serbisë mbi SelfNest d.o.o. Beograd-Zvezdara, Republika e Serbisë me seli të regjistruar më Njëzetentë nëntor 1, Beograd, Republika e Serbisë.

- Shoqëria për tregti dhe shërbime të jashtme dhe të brendshme NELT CO. d.o.o. Dobanovci i përket dhe punon në kuadër të grupit NELT. Grupi NELT filloi punën në vitin 1992 në tregti. Sot, grupi është aktiv në 11 tregje në rajonin e Evropës Juglindore dhe Afrikës Sub Saharë dhe ka rreth 4,000 punonjës. Grupi Nelt ofron shërbime të integruara të shpërndarjes dhe logjistikës për klientët e tij vendas dhe ndërkombëtarë nëpërmjet një rrjeti qendrash shpërndarjeje dhe mbështetje operative në çdo vend në të cilin është aktiv.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi Nelt është i pranishëm përmes tre ndërmarrjeve të tij:

-Nelt ST SHPKNJP me seli në Ilinden 32 nr.20 Shkup, e cila është aktive në distribucion;

-Nelt Log SHPKNJP me seli në Ilinden 32 nr.20 Shkup e cila është aktive në logjistikë dhe

-Nelt Lajn SHPKNJP me seli në Ilinden 32 nr.20 Shkup, e cila është aktive në transport.

- SelfNest d.o.o. Beograd-Zvezdara është kryesisht aktive në zhvillimin e projekteve të ndërtimit në Serbi. SelfNest d.o.o. Beograd-Zvezdara nuk gjeneron asnjë të ardhur në Maqedoninë e Veriut dhe nuk është e pranishme në Maqedoninë e Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

03.11. 2022

Shkup